

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E MENAXHIMIT TË TOKAVE DHE UJËRAVE NË MINISTRINË E BUJQËSISË E ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Menaxhimit të Tokave dhe Ujërave, me objekt “*Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomike dhe financiare.*” për periudhën 01.01.2013 deri 30.9.2014 si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së Nr. 995/9, datë 31.3.2015. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, për përmirësimin e gjendjes, me shkresën nr. 995/10, datë 07.04.2015, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar z. Edmond PANARITI, Ministër i Bujqësisë e Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A-PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME LIGJORE.

Auditimi i zhvilluar pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Tokave dhe Ujërave, u kufizua vetëm tek shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të kullimit dhe veprave mbrojtëse, pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve kullues, stacionet e pompimit, hidrovolet dhe të veprave mbrojtëse nga përmbytjet, për shkak se problemet e kullimit aktualisht në vendin tonë vazhdojnë të mbeten problemi i ditës duke qenë kështu një faktor kufizues për prodhimin por dhe një rrezik i vazhdueshëm i përmbytjeve, degradimit të tokës dhe humbjes së potencialeve prodhuese. Ajo që konstatohet është se forma e organizimit të deritanishëm, niveli i mbështetjes me punime sistematike, numri dhe gjendja e mjeteve të rënda nuk kanë arritur të sigurojnë një sistem efektiv dhe eficient të rrjetit të kullimit dhe pamundësi të veprave mbrojtëse për t’iu përgjigjur situatave emergjente. Nga ana tjetër konstatuam se *veprimtaria e bordeve të kullimit bazohet në Ligjin nr. 9860, datë 21.1.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, ndërkohë që funksionet e ujitjes, shpërndarjes së ujit dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes, mbeten funksion i shoqatave dhe federatave të përdoruesve të ujit.* Forma e organizimit në borde kullimi dhe federatat e ujitjes nuk kanë arritur të plotësojnë funksionet e përgjithshme të sistemeve kullim-ujitje. Bordet e kullimit si pjesë e strukturave shtetërore, mbeten institucione të pa konsoliduar dhe sipas legjislacionit dhe emërimit të tyre mbeten të pa angazhuara në problemet e ujitjes. Ato janë të përjashtuara nga funksionet që lidhen me administrimin e ujitjes, zhvillimin e ujitjes dhe sistemeve të ujitjes ose ushtrojnë funksione shumë të kufizuara, sikurse përcaktohet në nenin 39, pika 3, ku theksohet se “*bordi i kullimit me financim nga buxheti i shtetit, ndërmerr në raste të veçanta, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e një dige ose të kanalit kryesor ujitës, për një periudhë të caktuar*”. Gjykojmë se në aspektin ligjor përgjegjësia për sistemin e ujitjes nuk është e qartë. ***Për këtë është rekomanduar:***

-Ministria e Bujqësisë e Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të ngrejë një “*këshill teknik*” me ekspertë të fushës për të riparë aspektet ligjore, organizative dhe të funksionimit të lidhura me këto rrjete të rëndësishme, duke synuar gjetjen e një mënyre të re të organizimit të njësive që administrojnë dhe mirëmbajnë sistemet e kullimit, veprat mbrojtëse dhe të ujitjes duke synuar përmirësime të menjëhershme që do të futnin në efektivitet dhe efikasitet të plotë këto rrjete si faktorë bazë të përcaktimit të nivelit të prodhimit bujqësor, të mbrojtjes së tokës nga degradimi, mbrojtjes së qendrave të banuara nga përmbytjet dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor të vendit.

-Përvoja e deritanishme ka treguar se organizimi i menaxhimit të ujit për ujitje me ligj nga organizatat dhe federatat e përdoruesve të ujit, është mënyrë jo e përshtatshme për sa kohë nuk kemi një sistem të rehabilituar të ujitjes, prandaj duhet të rishikohet dhe të kombinohet me mënyrën e funksionimit të bordeve të kullimit.

Brenda datës 30.06.2015

B-MASA ORGANIZATIVE

1.Nga auditimi u konstatua se projektet e investimeve të objekteve të kullimit nuk i janë nënshtruar shqyrtimit nga një strukturë e përbërë nga ekspertë të fushës me përvojë si oponencë reale për të vlerësuar saktësinë e projektit si dhe në funksion të vendimarrjes për të zgjedhur variantin më të mirë nisur nga vlefshmëria e projektit, zgjidhjet që ofron, verifikimi në terren, kostot e veprës dhe efektivitetin e saj. Kjo mungesë opoence serioze ka çuar në një kosto të vazhdueshme për buxhetin e shtetit por jo në zgjidhjen e problemit, referuar dhe situatave të përsëritura të mosfunksionimit të këtyre objekteve me pasoja për qytetarët. **Për këtë është rekomanduar:**

-Projektet e investimeve të objekteve të kullimit ti nënshtrohen një procedure shqyrtimi nga një strukturë e përbërë nga ekspertë të fushës me përvojë që do të shërbente si garanci, për të vlerësuar alternativat e mundshme dhe për të zgjedhur variantin më të mirë, që do ti jepte zgjidhje problematikave në vite të këtyre sistemeve. Gjykojmë se një procedure e tillë, do të ndihmojë si oponencë për të vlerësuar realisht saktësinë e projektit nga një strukturë me ekspertizë në këtë fushë si dhe do të shqyrtojë vlefshmërinë e projektit, zgjidhjet, verifikimin në terren të problemeve kur është e nevojshme, vlerësojë kostot e projekteve, efektivitetin e veprës dhe mund të shprehet për përmirësimet e nevojshme. Duke vlerësuar se sistemi i kullimit dhe ujitjes në terren është një proces zinxhir, që kërkon lidhjen e sistemit edhe ndërmjet territoreve të qarqeve ku veprojnë borde të ndryshme një strukturë e tillë do të koordinojë përpjekjet me synim efektivitetin e sistemit dhe jo të një pjese të veçantë.

Në vijimësi

2.Konstatuam se vlera e studimeve e projekteve të paraqitura në pasqyrat financiare nën zërin “*Studime e projekte*” të “*Aktivitet e Qëndrueshme të pa Trupëzuar*” me përfundimin e investimit për të cilin ato janë hartuar nuk kanë kaluar në vlerën e objektit duke deformuar kështu paraqitjen e vlerës së plotë të investuar në veprat e realizuara.

Për këtë është rekomanduar:

-Të saktësohet në kontabilitet dhe në paraqitjen në pasqyrat financiare, vlera e studimeve për projektimet që aktualisht janë paraqitur nën zërin “*Studime e projekte*” të “*Aktivitet e Qëndrueshme të pa Trupëzuar*” dhe për të cilat investimi ka përfunduar dhe është marrë në dorëzim, duke e bërë pjesë këtë vlerë në vlerën totale të investimit për të cilin ato janë hartuar dhe duke u pasqyruar në zërin përkatës të “*Aktivitet të Qëndrueshëm të Trupëzuara*” me vlerë të plotë.

Në vijimësi

3. Konstatohet se tenderimi i fondeve për investime të objekteve të kullimit dhe ujitjes behet nga Ministria e Bujqësisë, ndërkohë që lidhja e kontratës, zbatimit dhe marrjes në dorëzim të punës së kryer e bëjnë bordet e kullimit. Kjo mënyrë dobëson kontrollin mbi investimet e realizuara dhe shpërndan përgjegjësitë lidhur me defektet në realizimin e investimeve që kryen në lidhje me objektet e kullimit dhe të ujitjes. Këtë fakt e përforcon edhe konstatimi që nga autoritetet kontraktore nuk janë ngritur komisione dhe nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim të punimeve të realizuara apo shërbimeve të kryera sipas kontratës dhe kërkesave të VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “*Për rregullat e prokurimit publik*” kreu VIII, pika 2/b, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, UMF nr. 92, datë 29.12.2011, “*Për gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë*”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, pika 42, 54, fakt që ka lënë shteg edhe për formalitet në realizimin në vijimësi të këtyre punimeve, shërbimeve nga autoritetet kontraktore dhe ka ndikuar në uljen e nivelit të përgjegjëshmërisë së kontraktuesve të këtyre shërbimeve. **Për këtë është rekomanduar:**

a-Të përcaktohet një procedurë e plotë dhe e vlerësuar me kujdes për çdo etapë që shoqëron planifikimin, vlerësimin dhe realizimin e investimeve në lidhje me punimet,

shërbimet si dhe të përcaktohet përgjegjësia institucionale që do të sigurojë monitorimin e realizimit të këtyre investimeve.

Brenda datës 30.06.2015

b- Nga autoriteti kontraktor për të gjitha kontratat e furnizimit me mallra, punime/shërbime të ngrihen komisione dhe të hartohen procesverbale për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për t'u siguruar për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe dokumentacionit shoqërues sipas kushteve të kontratave dhe në përfundim të kontratës të përgatitë një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, duke synuar në këtë rast që fondet e shtetit janë përdorur me efikasitet dhe në mënyrën e duhur.

Në vijimësi

4. Nga auditimi i realizuar në objektin “Mbrotja nga Lumi Seman i Bregut dhe Argjinaturës në Krahun e Majtë të Gropës së Rrodhes” Fier, u konstatua se:

-Objekti kishte pësuar çedime dhe plasaritje të mbulesës së betonit të peneleve si rezultat i mos vendosjes së fugave në penele dhe vendosjes së betonit me cilësi të dobët. Kallëpet e betoneve nuk janë kryer me cilësi të mirë dhe betoni nuk është vibruar sipas standardeve, fakt që ka sjellë dhe deformime të ndryshme dhe mosarritjen e markës të betonit të përcaktuar në projekt në pjesë të ndryshme të peneleve.

-Kontraktori duhet të kryej të gjitha riparimet në pjesët e dëmtuara të peneleve dhe Autoriteti Kontraktor të mos paguaj vlerën e garancisë prej 488,932 lekë me t.v.sh deri në kryerjen e riparimeve me cilësinë e kërkuar në projekt dhe sipas kushteve teknike të zbatimit. Konstatohet se është vepruar në kundërshtim me të nenit 7, 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve z. [REDAKTUAR], kolaudatorët e punimeve z. [REDAKTUAR] dhe z. [REDAKTUAR].

Për këtë është rekomanduar:

- Kontraktori duhet të kryej riparimet në të gjitha pjesët e dëmtuara të peneleve në objektin “Mbrotja nga Lumi Seman i Bregut dhe Argjinaturës në Krahun e Majtë të Gropës së Rrodhes” Fier, të zhvilluar në vitin 2013, duke zbatuar projektin, mbështetur në kushtet teknike të zbatimit dhe Autoriteti Kontraktor të mos paguajë vlerën e garancisë prej 488,932 lekë me t.v.sh deri në kryerjen e të gjitha riparimeve.

Menjëherë

5. Nga auditimi i realizuar në objektin “Rehabilitimi i Kanalit Ujitës-Rezervuari Turbullit” Fier, të zhvilluar në vitin 2014 u konstatua se:

-Në disa pjesë të sistemit ujitës ka pasur shkarje dhe dëmtime të kanalit, si rezultat i punimeve në terren të paqëndrueshëm dhe me shkarje.

-Kontraktori nuk ka marrë masat e duhura për hedhjen e betoneve dhe formimin e kallëpeve për të përfunduar bazamentin ose skarpatën ku është vendosur kanali.

-Në disa pjesë të sistemit ujitës është konstatuar se betonet nuk janë të cilësisë të kërkuar në projekt, kjo për shkak të mos vibrimit dhe dehidratimit të betonit gjatë fazës të hedhjes së tij në vepër dhe në pjesë të ndryshme të sistemi ujitës është konstatuar çarje e kanali ujitës, si pasojë e ndërhyrjeve të jashtme nga poseduesit e tokave ku kalon kanali.

-Kontraktori duhet të kryej riparimet në të gjitha pjesët e dëmtuara, duke zbatuar projektin dhe duke u mbështetur në kushtet teknike të zbatimit dhe Autoriteti Kontraktor të mos paguajë vlerën e garancisë prej 863,378 lekë me t.v.sh deri në kryerjen e të gjitha riparimeve të sipërpërmendura. Konstatohet se është vepruar në kundërshtim me të nenit 7, 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve z. [REDAKTUAR], kolaudatorët e punimeve z. [REDAKTUAR] dhe z. [REDAKTUAR]. ***Për këtë është rekomanduar:***

-Kontraktori duhet të kryej riparimet në të gjitha pjesët e dëmtuara në objektin “Rehabilitimi i Kanalit Ujitës-Rezervuari Turbullit” Fier, të zhvilluar në vitin 2014, duke zbatuar projektin dhe duke u mbështetur në kushtet teknike të zbatimit kurse Autoriteti Kontraktor të mos paguajë vlerën e garancisë prej 863,378 lekë me t.v.sh deri në kryerjen e të gjitha riparimeve.

Menjëherë

6. Nga auditimi i realizuar në objektin “Mbrotje nga lumi Osum në Velabisht, Berat”, të zhvilluar në vitin 2013 është konstatuar se nga verifikimi në terren i argjinaturës dhe peneleve u konstatua se peneli nr. 4 është i dëmtuar, për këtë Kontraktori është i detyruar të kryej të gjitha riparimet në pjesët e dëmtuara të peneleve. Autoriteti Kontraktor detyrohet mos të bëjë pagesën e garancisë prej 5% në vlerën prej 1,290,684 lekë me t.v.sh. derisa Kontraktori të kryej këto riparime me cilësinë e kërkuar dhe sipas kushteve teknike të zbatimit. **Për këtë është rekomanduar:**

-Kontraktori duhet të kryej riparimet në të gjitha pjesët e dëmtuara të peneleve në objektin “Mbrotje nga lumi Osum në Velabisht, Berat” Berat, të zhvilluar në vitin 2013, duke zbatuar projektin, mbështetur në kushtet teknike të zbatimit dhe Autoriteti Kontraktor të mos paguajë vlerën e garancisë prej 1,290,684 lekë me t.v.sh deri në kryerjen e të gjitha riparimeve.

Menjëherë

7. Nga auditimi rezulton se detyrimet e lëna për zbatim nga KLSH me shkresën nr. 136/6, datë 22.7.2011 një pjesë janë evidentuar në kontabilitet, janë njoftuar subjektet për shlyerjen e detyrimit dhe janë bërë kërkesë padi për shpërblimin e dëmit të shkaktuar dhe rezulton se një masë organizative nuk është zbatuar. **Për këtë është rekomanduar:**

-Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, pika b, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kapitulli IV “Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve” pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike Bordi i Kullimit Shkodër (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit, duke ndjekur të gjitha hapat ligjorë (administrativë, gjyqësorë e përmbarimore) duke filluar me rakordimet për volumet e kryera nga ekskavatorët me krah të gjatë të angazhuar nga disa borde kullimi për llogari të subjektit privat “S.....” sh.p.k. për zbatimin e punimeve për “Rehabilitimin e kanalit të Murtemzës”, Shkodër, dhe pasuar me kërkesën e arkëtimit të vlerës 780,585 lekë të dala nga rakordimi në favor të Bordi Kullimit, Fier i cili ka angazhuar 1 ekskavator.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Në tenderat e zhvilluar me objekt “Blerje karburant”, nga llogaritja e furnizimit të likuiduar për subjektin “██████” sh.p.k, “██████” sh.p.k, “██████” sh.p.k , “██████” sh.a. rezulton se nga mos respektimi i çmimit të miratuar sipas kontratës për furniturën, bazuar në çmimit referuar bursës REUTERS botuar në buletin e APP, deklaratën doganore SAD, janë likuiduar 874,380 lekë pagesa më tepër përfituar në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” Kreu VIII, pika 2/c dhe datë 31.12.2011 neni 4 dhe duhet të arkëtohen. **Për këtë është rekomanduar:**

-Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, pika b, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kapitulli IV “Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve” pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit, duke ndjekur të gjitha hapat ligjorë në vlerën 874,380 lekë si më poshtë për:

1-Operatorin “██████” sh.a. për vlerën 345,107 lekë, e cila rezulton nga mos respektimi i çmimit të miratuar sipas kontratave për furniturën, bazuar në çmimit referuar bursës REUTERS botuar në buletin e APP, deklaratës doganore SAD, respektivisht: vlerën 257,115 lekë sipas kontratës “Blerje karburant për vitin 2013”, vlerën 9,120 lekë sipas shtesës kontratës “blerje karburant 2013” dhe vlerën 78,872 lekë sipas kontratës “blerje

karburant 2014” përfituar në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu VIII, pika 2/c dhe duhet të arkëtohet në **Bordin e Kullimit Tiranë**.

2-Operatorin “██████” sh.p.k. për vlerën 188,536 lekë, e cila rezulton nga mos respektimi i çmimit të miratuar sipas kontratave për furniturën, bazuar në çmimit referuar bursës REUTERS botuar në buletin e APP, deklaratës doganore SAD, për kontratën “blerje karburant 2014” përfituar në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu VIII, pika 2/c dhe duhet të arkëtohet në **Bordin e Kullimit Tiranë**.

3-Operatorin “██████” sh.p.k. për vlerën 212,098 lekë, e cila rezulton nga mos respektimi i çmimit të miratuar sipas kontratave për furniturën, bazuar në çmimit referuar bursës REUTERS botuar në buletin e APP, deklaratës doganore SAD, për kontratat “blerje karburant” përfituar në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu VIII, pika 2/c dhe duhet të arkëtohet në **Bordin e Kullimit Lushnjë**.

4-Operatorin “██████” sh.a. për vlerën 128,639 lekë, e cila rezulton nga mos respektimi i çmimit të miratuar sipas kontratave për furniturën, bazuar në çmimit referuar bursës REUTERS botuar në buletin e APP, deklaratës doganore SAD, për kontratat “blerje karburant”, përfituar në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu VIII, pika 2/c dhe duhet të arkëtohet në **Bordin e Kullimit Fier**.

Menjëherë

2. Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjet teknike rezulton se në situacionet përfundimtare janë paguar zëra punimesh të parealizuara, zëra këto të cilët nuk janë pasqyruar në librezën e masave, aktet e kontrollit dhe ditarin e punimeve. Si rrjedhojë janë likuiduar situacione për punë të pakryera të përfituara nga subjektet në vleftën 2,635,006 lekë. **Për këtë është rekomanduar:**

-Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, pika b, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kapitulli IV “Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve” pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit, duke ndjekur të gjitha hapat ligjorë në vlerën **2,635,006** lekë si më poshtë për:

1-Operatorin “██████” sh.p.k. në vlerën 28,710 lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Rikonstruksion vepra arti dhe mbrojtje në kanalin Peqin- Kavajë”, viti 2013 dhe duhet të arkëtohet në **Bordin e Kullimit Tiranë**.

2-Operatorin “██████” sh.p.k. në vlerën 922,608 lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Rehabilitimi i Sistemit Ujitës Okshtun 1”, vitin 2014 dhe duhet të arkëtohet në **Bordin e Kullimit Tiranë**.

3-Operatorin “██████” sh.p.k. për vlerën 238,056 lekë, me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mbrojtje nga Lumi Shkumbin Zona Kular-Divjakë”, vitin 2014 dhe duhet të arkëtohet në **Bordin e Kullimit Lushnjë**.

4-Operatorin “██████” sh.p.k. në vlerën 335,616 lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mbrojtje nga Lumi Drin i Zi fshati Gjoricë”, vitin 2014 dhe duhet të arkëtohet në **Bordin e Kullimit Dibër**.

5-Operatorin “██████” sh.a. në vlerën 85,720 lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mbrojtje nga Lumi Drin i Zi fshati Gjoricë”, vitin 2014 dhe duhet të arkëtohet në **Bordin e Kullimit Dibër**.

6-Operatorin “██████” sh.p.k. në vlerën 193,167 lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mbrojtje nga Lumi Drin i Zi fshati Podgoricë”, vitin 2013 dhe duhet të arkëtohet në **Bordin e Kullimit Dibër**.

7-Operatorin “██████” sh.p.k. në vlerën 831,129 lekë me t.v.sh. për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mbrotje nga lumi Osum në Velabisht, Berat”, vitin 2013 dhe duhet të arkëtohet në **Bordin e Kullimit Berat**.

Menjëherë

3. Në tenderin e Bordit të Kullimit Tiranë “Blerje karburanti 2014”, nga KVO është s’kualifikuar operatori “██████” sh.p.k. me ofertën me marzh fitimi 7.91 lekë/litri pa t.v.sh. me arsyetimin se dokumentet e paraqitura në formatin elektronik i kishte “jo-origjinale por fotokopje”. Nga auditimi rezultoi se dokumentet e paraqitura nga operatori i mësipërm në formatin elektronik përmbajnë të gjithë elementët formalë dhe materiale që duhet të ketë një akt administrativ dhe janë në përputhje me DST e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Diferenca midis dy ofertave atij fitues “██████” sh.p.k dhe “██████” sh.p.k. të s’kualifikuar padrejtësisht është 680,062 lekë ($39,793 \times 17.09 = 680,062$ lekë) përbën dëm ekonomik dhe duhet të arkëtohet nga KVO dhe Komisioni për shqyrtimin e ankesës.

Për këtë është rekomanduar:

- Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, pika b, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kapitulli IV “Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve” pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike **Bordit të Kullimit Tiranë** (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit, duke ndjekur të gjitha hapat ligjorë (administrativë, gjyqësorë e përmbartimore) në vlerën 680,062 lekë:

-Për anëtarët e KVO ██████ dhe Komisionit për shqyrtimin e ankesës ██████ nga 113,343 lekë secili, pasi në tenderin “Blerje karburanti 2014” nga KVO kanë s’kualifikuar operatorin “██████” sh.p.k. me ofertën me marzh fitimi 7.91 lekë/litri pa t.v.sh. naftë me arsyetimin: “Operatori, vërtetimin e shlyerjes së taksave vendore lëshuar nga Bashkia Tiranë e kishte jo-origjinale por fotokopje. Të njëjtën parregullsi kishte edhe me sigurimin e ofertës...”, kur këto dokumente të paraqitura nga operatori i mësipërm në formatin elektronik përmbajnë të gjithë elementët formalë dhe materiale që duhet të ketë një akt administrativ dhe janë në përputhje me DST e kërkuara nga autoriteti kontraktor, duke sjellë një dëm ekonomik prej 680,062 lekë.

Menjëherë

4. Në tenderin e Bordit të Kullimit Fier, “Rikonstruksioni i përkohshëm i kanalit ujitës Dega e Martinës” 2014, nga KVO është skualifikuar bashki,i i operatorëve “██████ & ██████” sh.p.k. kur nga auditimi rezulton se ka paraqitur dokumentet në përputhje me kërkesat e DST dhe duhej të kualifikohej nga KVO, të shpallej fitues me ofertën 3,281,081 lekë pa t.v.sh. dhe duhej të lidhej kontrata. Diferenca me ofertën 3,665,024 lekë pa t.v.sh. e operatorit fitues “██████” sh.p.k. përbën dëm ekonomik ($3,665,042 - 3,281,943 = 383,099$ lekë) dhe duhet të arkëtohen nga KVO, dhe Komisioni për shqyrtimin e ankesës.

Për këtë është rekomanduar:

- Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, pika b, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kapitulli IV “Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve” pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike **Bordit të Kullimit Fier** (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit, duke ndjekur të gjitha hapat ligjorë (administrativë, gjyqësorë e përmbartimore) në vlerën 383,099 lekë si më poshtë:

- Për anëtarët e KVO-së ██████ dhe Komisioni për shqyrtimin e ankesës ██████ nga 76,620 lekë secili, pasi në tenderin “Rikonstruksioni i përkohshëm i kanalit ujitës Dega e ██████” 2014, nga KVO është skualifikuar padrejtësisht operatori “██████” sh.p.k. kur kanë paraqitur dokumentet e kërkuara sipas kërkesave të DST: Certifikatën ISO 9001-

2008, kontrata e ngjashme. Diferenca me ofertën 3,665,024 lekë pa t.v.sh. e operatorit fitues “██████” sh.p.k. përbën dëm ekonomik (3,665,042 – 3,281,943 = 383,099 lekë).

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, germa ç, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenin 13 dhe 72, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu XI, neni 79, pika 1, ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” neni 7, pika 2,3/a, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, për anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, si më poshtë:

A-Bordi i Kullimit Tiranë:

- 1- ██████ anëtar i KVO,
- 2- ██████ anëtar i KVO,
- 3- ██████ anëtar i KVO,

për arsye se: Nga auditimi i procedurës së prokurimeve për tenderat janë konstatuar gjetje si më poshtë: Nga KVO janë hartuar raportet përmbledhës të firmosur nga kryetari i KVO dhe jo nga komisionet e vlerësimit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreut V, pika 4, germa gj: germa h.

Në tenderin “Blerje karburanti 20014” nga KVO është s’kualifikuar operatori “██████” sh.p.k. me ofertën me marzh fitimi 7.91 lekë/litri pa t.v.sh. naftë me arsyetimin: “Operatori, vërtetimin e shlyerjes së taksave vendore lëshuar nga Bashkia Tiranë e kishte jo-origjinale por fotokopje. Të njëjtën parregullsi kishte edhe me sigurimin e ofertës...”.

Këto dokumente të paraqitura nga operatori i mësipërm në formatin elektronik përmbajnë të gjithë elementët formalë dhe materiale që duhet të ketë një akt administrativ dhe janë në përputhje me DST e kërkuara nga autoriteti kontraktor pasi të gjithë dokumentet e hedhura nga operatorët janë dokumente të skanuara.

KVO ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, dt. 20.11.2016 “Për prokurimin publik” neni 53, pika 1, VKM nr. 1. Datë 10.01.2007, kreut V, pika 4, germa g:, “Manualin e Përdorimit të Sistemit të Prokurimit Elektronik për Operatorët Ekonomikë”, dt. 02.4.2012 hartuar nga Agjensia e Prokurimit Publik, faqja 7, paragrafi i fundit ku përcaktohet se: “versioni i skanuar i këtyre dokumenteve pasi hidhet në sistemin elektronik të prokurimit për një procedurë konkrete është i barasvlershëm me dokumentin origjinal ose kopjen e noterizuar”.

Diferenca midis dy ofertave atij fitues “██████” sh.p.k dhe “██████” sh.p.k të s’kualifikuar padrejtësisht 680,062 lekë përbën dëm ekonomik dhe mbajnë përgjegjësi KVO dhe Komisioni për shqyrtimin e ankesës.

B-Bordi i Kullimit Fier:

- 1- ██████, kryetar i KVO,
- 2- ██████, anëtar i KVO,
- 3- ██████, anëtar i KVO,
- 4- ██████, anëtar i KVO,
- 5- ██████, anëtar i KVO,
- 6- ██████, anëtar i KVO,

për arsye se: Nga auditimi i procedurës së prokurimeve për tenderat janë konstatuar gjetje si më poshtë:

Në tenderin “Rikonstruksioni i përkohshëm i kanalit ujitës Dega e Martinës” 2014, nga KVO është skualifikuar bashkimi i operatorëve “██████” sh.pk. kur kanë paraqitur:

a-Certifikatën ISO 9001: 2008 për fushat e veprimtarisë, kontrata me Borde kullimi Operatori “██████” sh.pk. duhej të kualifikohej nga KVO, të shpallej fitues me ofertën 3,281,081 lekë pa t.v.sh. dhe duhej të lidhej kontrata.

Diferenca me ofertën 3,665,024 lekë pa t.v.sh. e operatorit fitues “██████” sh.p.k. përbën dëm ekonomik ($3,665,042 - 3,281,943 = 383,099$ lekë).

S’kualifikimi i operatorit “██████” sh.pk. është në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, kreut V, pika 4, germa ç;

Me shkresën e autoritetit kontraktor nr. 148/4, dt. 28.5.2014 është anuluar procedura për mungesë konkurrence dhe tenderi “*Shërbim e Mirëmbajtje Pajisje Elektrike Mekanike në Hidrovor 2014*”, është zhvilluar në datën 19.6.2014.

Në raportin përmbledhës i firmosur nga anëtarët e KVO, miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimin dhe s’kualifikimin e operatorëve është kualifikuar operatori “██████” “██████” sh.p.k. me ofertën 3,025,000 lekë pa t.v.sh.

Ky operator është skualifikuar në procedurën e mëparshme të anuluar për këtë tender duke paraqitur të njëjtat dokumente si edhe në procedurën e datës 19.6.2014, ku është kualifikuar duke pasur po ato mangësi për të cilat është skualifikuar në procedurën e parë.

Komisioni i vlerësimit të ofertave në këtë rast duhej të skualifikonte operatorin, të ndërpriste procedurën dhe të kërkonte fillimin e një procedure të re sipas VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreut V, pika 4, germa ç; kreut VII, pika 1, germa a. Për këtë mban përgjegjësi KVO, ██████

Në tenderin “*Blerje pajisje Elektrike e Mekanike në Hidrovoret 2013*”, nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga anëtarët e KVO, miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor mbi ecurinë e procedurës së tenderit, ku është kualifikuar operatori “██████” sh.pk. me ofertën 1,590,000 lekë pa t.v.sh. pa plotësuar kërkesat e DST, duke mos paraqitur “*kopjen e faturës tatimore të shitjeve për shërbime e furnizime të ngjashme*”, “*Certifikata e origjinës së mallit*” e pa përkthyer, në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, kreut V, pika 4, germa ç; dhe mbajnë përgjegjësi KVO ██████

KONTROLI I LARTË I SHTETIT